

POP

**PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE**



ZGJEDHJET VENDORE 14 MAJ 2023

KONTRATA SOCIALE



VAU I DEJES



Center for Election and Development Center
Kendra Qendrore e Zhvritjes dhe zhvillimit



KONTRATA SOCIALE 2023 – 2027 BASHKIA VAU I DEJËS

Përballja e Ofertave Politike (POP) është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare, të cilat punojnë në 12 bashki të Shqipërisë. Në bashkinë Vau i Dejës, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga Qendra “Hapa të Lehtë”. “Hapa të Lehtë” është një organizatë që punon për të drejtat e njeriut, me fokus të veçantë të drejtat e grave. Punon për integrimin social të grave dhe vajzave në zonat rurale, nepërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse dhe komponentit të fuqizimit ekonomik.

Kontrata sociale hartohet nga POP në çdo fushatë elektorale gjatë Zgjedhjeve Vendore në Shqipëri. Kontrata sociale prezantohet te të gjithë kandidatët për kryetar bashkie gjatë periudhës së fushatës elektorale.

Në hartimin e kontratës sociale 2023-2027 janë marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e grupeve të ndryshme të qytetarëve brenda territorit të Bashkisë Vau i Dejës, me një fokus të veçantë për grupet e cënueshme.

PRIORITETET KRYESORE

Prioriteti 1. Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor

- Krijimi i një strategjie të re në shpërndarjen e informacionit, kryesisht për atë që lidhet ngushtësisht me interesat e qytetarëve, ndikimin e jetës së tyre (si: programet e ndryshme të nxitjes së punësimit, biznesit, strehimit etj).
- Faqe interneti lehtësisht e aksesueshme, e përditësuar me të gjitha informacionet e nevojshme që nuk kanë nevojë për kërkesë.
- Vendosja e disa info points të digjitalizuara në pika strategjike të qytetit, me qëllim informimin e qytetarëve, kryesisht vizitorëve vendas dhe të huaj.
- Fuqizimi i mekanizmave komunitaë të përfaqësimit:
 - Këshilli Vendor i Rinisë dhe ndikimi i tij në politikat vendore për të rinjtë. Fuqizimi i Këshillave vendorë lokalë si mekanizma konsultues dhe monitorues të politikave rinore.
 - Këshilli Vendor i Sigurisë Publike.
- Digjitalizimi i shërbimeve ka krijuar vështirësi për aksesin e qytetarëve në shërbimet online, ndaj kërkohet ofrimi i shërbimeve edhe me mënyra alternative ose funksionimi në mënyrë paralele me mënyrat tradicionale si ofrimi i shërbimeve paralelisht edhe në Njësi Administrative.

- Banorët kërkojnë të informohen më shumë mbi zhvillimin e takimeve publike dhe të Buxhetimit me Pjesëmarrje, në mënyrë që të jenë më të përfshirë në vendimmarrje për çështjet që i shqetësojnë.

Prioriteti 2. Drejtësia Sociale

- Shërbimet Sociale për grupet në nevojë: Ngritja dhe vënia në funksion e Qendrave Sociale, duke e konsideruar si pikë të rëndësishme për koordinimin dhe adresimin e problemeve në Bashki.
- Adresimi i dhunës me bazë gjinore: Organizimi i më shumë fushatave dhe programeve ndërgjegjësuese kundër dhunës ndaj grave e vajzave dhe dhunës në familje.

Prioriteti 3. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor

- Nxitje për krijimin dhe zhvillimin e programeve për gratë dhe të rinjtë për fuqizimin ekonomik të tyre.
- Shërbime dhe programe për përfshirjen e të rinjve.
- Ofrimi i lehtësirave fiskale për bizneset e vogla me qëllim zhvillimin ekonomik vendor.

Prioriteti 4. Transport publik i aksesueshëm dhe i sigurtë për të gjithë qytetarët e Vaut të Dejtës

- Vënia në funksion e transportit publik i cili mungon në të gjithë bashkinë.

Prioriteti 5. Shkollat, Kopshtet dhe Çerdhet

- Përmirësimi i infrastrukturës dhe ngrohjes së shkollave në fshatrat Pistull dhe Paçram në njësinë administrative Hajmel.
- Ndërtimi i terreneve sportive në njësinë administrative Hajmel.
- Rikonstruksioni i shkollës dhe ndërtimi i palestrës në njësinë administrative Mjedë
- Kopshtet me drekë dhe çerdhet mungojnë në të gjithë territorin e bashkisë dhe kërkohet adresimi me prioritet i kësaj çështjeje.

PRIORITETE TË TJERA

Prioriteti 6. Infrastruktura Rrugore dhe Ndriçimi

- Ndriçimi i rrugëve dytësore të tre njësi administrative të bashkisë Vau i Dejtës

Njësia administrative Bushat:

- Rikonstruksion i rrugës së Malësorëve
- Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve të brendshme të fshatit Rranxa

Njësia administrative Hajmel:

- Sistemimi i rrugës “Shën Pali-Qershia”
- Mirëmbajtje e rrugës Shelqet – Pistull, vendosje e barrjerave mbrojtëse anës rrugës
- Punime meremetimi urash në njësinë administrative Hajmel
- Sistemimi i rrugës “Dheu i Lehtë”, Pistull

Njësia administrative Vau i Dejtës:

- Sistemim, asfaltim dhe ndriçim i rrugës “Pecaj – Shelqet”
- Sistemim, asfaltim i rrugës "Don Nikolli", Laç
- Sistemim, asfaltim i rrugës së Komanit, rrugës që lidh rrugën kryesore me Hidrocentralin

Prioriteti 7. Uji i pijshëm dhe Kanalizimet.

A. Uji i Pijshëm

- Kërkohe furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë në të tre njësitë administrative
- Klorinimi në mënyrë të rregullt.
- Oraret gjatë stines së veres duhet të jenë më të zgjatura
- Nevojitet më shumë rregullsi në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit në të gjithë Bashkinë.

B. Kanalizimet

- Sistemi i kanalizimeve të ujrave të zeza pranë shkollës “Nënë Tereza”

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP” synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- | | |
|---|---|
| • Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë; | • Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; |
| • Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; | • Qendra Rinore për Progres, Kukës, |
| • Qendra Rinore Vlorë, | • Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec; |
| • Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz; | • Gruaja në Zhvillim, Korçë; |
| • Epoka e Re, Fier; | • Hapa të Lehtë, Vau i Dejës; |
| • Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; | • Tjetër Vizion, Elbasan |